



REPUBLIKA E KOSOVË - RUSTRIBUNA E GJITHË
KOMUNA E VUSHTRISË - OPSTINA VUÇITRA

01 Nr./Br. 126/19

Nr./Eq./Br. si - 1 -

Data/ Datum 25.04.2019



Republika e Kosovës


Kuvendi i Komunës - Vushtrri

Bazuar në nenin 12, paragrafi 2, pika "d", në lidhje me nenin 40, paragrafi 2, pika "c" të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 41, paragrafi 2, pika "ç" në lidhje me nenin 40, paragrafi 2, pika "dh" të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më datë **25 prill 2019** merr këtë:

**VENDIM
PËR APROVIMIN E MJETERVE FINACIARE PËR BLERJE TË
ESKAVATORIT**


1. Me këtë vendim aprovohet propozimi i Kryetarit të Komunës për blerjen e një ekskavatori për nevojat e drejtorive të komunës dhe me qëllim të efikasitetit të punëve. Blerja e ekskavatorit do të bëhet në shumën deri në tridhjetë mijë (30.000 € euro).
2. Pagesa e mjeteve financiare të cekura në pikën një (1) të këtij vendimi, do të bëhet nga buxheti i komunës, (përkatësisht fondi për bashkëfinancim në Drejtorinë e Shërbimeve Publike).
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria për Buxhet edhe Financa, si dhe Drejtoria e Prokurimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Nasuf Aliu



Kryesues i Kuvendit





Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës - Vushtrri

Bazuar në nenin 12, paragrafi 2, pika "d" të Ligjit Nr. 03/L-040 /2008, për Vetëqeverisje Lokale, nenin 41, paragrafi 2, pika "ç" në lidhje me nenin 40, paragrafi 2, pika "l" të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më **25 prill 2019**, merr këtë:

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT KUVENDAR PËR VERIFIKIMIN E
SHPËRNDARJES SË SUBVENCIONEVE DHE GRANTEVE

1. Me këtë vendim formohet komisioni nga Kuvendi i komunës për verifikimin e procesit të shpërndarjes së subvencioneve (serrave) dhe granteve nga Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, në përbërjen si në vijim:

- 1.1 Kushtrim Hyseni, anëtar i kuvendit (PDK);
- 1.2 Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit (LVV);
- 1.3 Agron Përçuku, anëtar i kuvendit (LDK);
- 1.4 Basri Menxhiqi, anëtar i kuvendit (AAK)
- 1.5 Fakete Dushi, anëtare e kuvendit (AKR);
- 1.6 Sadije Bajgora, anëtare e kuvendit (LB) dhe
- 1.7 Abdullah Vojvoda, anëtar i kuvendit (Nisma Socialdemokrate).

2. Komisioni i cekur në pikën 1 të këtij vendimi do të ketë për obligim, të bëjë verifikimin e dokumentacionit komunal në Drejtorinë e Ekonomisë, Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, që ka të bëjë me procesin e shpërndarjes së subvencioneve dhe granteve në Komunën e Vushtrrisë, dhe konform hulumtimeve do të hartojë raport lidhur me të gjeturat në këtë proces, dhe po ashtu të njëjtin raport do t'ia adresojë Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, si dhe komisioni i cekur në pikën 1 të këtij vendimi.

4. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Nasuf Aliu



Kryesues i Kuvendit



REPUBLIKA E KOSOVES
KOMUNA E VUSHTRRISË

DI Nr. / Br. 128 / 19

Nr. i fq. / Br. sh. - 1 -

Data / Datum 25.04.2019

VUSHTRRI




Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës - Vushtrri

Bazuar në nenin 12, paragrafi 2, pika "d" të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenin 41, paragrafi 2, pika "ç" të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, si dhe duke u bazuar në propozimin e anëtarit të kuvendit z. Shpëtim Zhegrova, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më datë **25 prill 2019** merr këtë:

**VENDIM
PËR OFRIMIN E NDIHMËS FINANCIARE**

1. Me këtë vendim lejohen mjete financiare në vlerë prej dy mijë euro (2.000 €) nga buxheti i komunës nga kategoria e subvencioneve, në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale për Hakif Krasniqin me banim në fshatin Gllavatin, Komuna e Vushtrrisë.
2. Shuma e cekur në pikën 1 të këtij vendimi, ndahet në emër të Hakif Krasniqit dhe do të shërbejë për ndërtimin e shtallës së bagëtive, pasi ajo i ishte djegur nga një fatkeqësi nga zjarri.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.



Nasuf Aliu

Kryesues i Kuvendit